# Kardiokirurgji e standarteve ndërkombëtare, Spitali Amerikan shpëton jetë!

Nga Gazeta Tribuna

17:44 / 21 Shtatorë 2017 | LIFESTYLE



**Pacientja Haxhire Rama 49 vjeç ( BMI 50 ) pas dhimbjeve të forta që kishte në gjoks është paraqitur në njërin nga spitalet në vend, ku i është bërë CT-Angiografi e Thoraxit si dhe i është lëshuar Diagnoza Disekcion tip B (çarje e Aortës nën A.subclavia majtas).**

ME SHUME NGA LAJME



1 orë më parë | LAJME
Ti Fatmir e unë Fatmir – ish - presidenti...





1 orë më parë | LAJME
Ngjarje tragjike në Komoran: 28-vjeçarja...



1 orë më parë | LAJME
Atmosfera brenda takimit VV-LDK, nuk mun...



1 orë më parë | LAJME
I ndalohet hyrja në Kosovë zëvendësit të...



1 orë më parë | LAJME
Nënshkruhet marrëveshja për grantin "Ta ...

ME TE LEXUARAT

Më pas pacientja në fjalë është liruar për në shtëpi. Pas dy ditëve gjendja e saj është përkeqësuar akoma dhe më shumë, problemet e saj të theksuara ishin frymëzënia dhe dhimbjet në gjoks.

Është paraqitur në Spitalin Amerikan me një hemodinamik jo stabile. Pulsi i zemrës mbi 150/min dhe Tensionet nën 70/40 mmHg.

Në CT shihet që çarja e Aortës fillon në Aortën asendente duke vazhduar gjatë gjithë aortës deri në Arteriet femorale në të gjitha anët. Është vërejtur që kemi të bëjmë me Disekcion Tip A dhe me indikacion për futje urgjente në sallë.

Pacientja 49 vjeçare, urgjentisht është futur në sallë dhe i është bërë zëvendësim i Aortës ascendente me gjysmëhark (Hemiarch). Operacioni bëhet me Hipotermi të moderuar 28C dhe përfusion selektiv të kokës.

Pacientja Rama tashmë është në gjendje të mirë shëndetësore, madje ajo thotë se fal ekipit mjekësor të Kardiokirurgjisë së Spitalit Amerikan, ajo vazhdon të jetojë.

“Jam shumë mirënjohëse të gjithë mjekëve te Spitalit Amerikan, e në veçanti Dr. Fatos Kojqiqit dhe Dr.Besnik Kojcicit ku fal tyre unë po vazhdoj të jetojë. Kur kam ardhur në spital kam menduar që është dita ime e fundit sepse isha shumë keq, kisha probleme në frymëmarrje dhe probleme me zemrën. Tash jam shumë mirë dhe pas 2 ditëve do të dal nga spitali”, thotë pacientja 49 vjeçare Haxhire Rama

Operacioni ka kaluar me shumë sukses dhe pacientja është zgjuar menjëherë të nesërmen dhe aktualisht trajtohet në repartin mjekësor.

Intervenimin e kanë realizuar Kardiokirurgët Dr.med. Fatos Kojqiqi, Dr.med. Besnik Kojcici si dhe ekipi mbështetës i sallës së bashku me anasteziologët. Sipas mjekëve pacientja Haxhire Rama ka qenë me shumë fat në këtë rast, që ka mundur të mbërrijë herën e dytë në spital. Këto sëmundje kërkojnë ndërhyrje urgjente kirurgjike pasi rrezikshmëria e tyre pa operacion është 1% në orë.

Kjo është pacientja e 19 që ka marrë trajtimin adekuat në Spitalin Amerikan me të tilla probleme kardiake.





TE NGJASHME



1 orë më parë | LIFESTYLE

Si Të Përdorni Aloe Verën për Problemet me Lëkurën e Fytyrës



43 minuta më parë | LIFESTYLE

Kura me 12 thelpinjë hudhra për largimin e peshës së tepërt



3 orë më parë | LIFESTYLE

Horoskopi 23 tetor 2019, ja parashikimi i yjeve për ju



4 orë më parë | LIFESTYLE

Çfarë mendojnë meshkujt kur vajzat bëhen xheloze dhe posesive në ...



14 orë më parë | LIFESTYLE

Si të jeni gënjeshtarë më të mirë



14 orë më parë | LIFESTYLE

Afshet e nxehta në menopauzë; si duhen trajtuar dhe menaxhuar



© Gazeta Tribuna. All Rights Reserved